

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË
PËR VITIN 2019

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Bankës së Shqipërisë në mbikëqyrjen e sistemit financiar të vendit dhe nxitjen e rritjes së qëndrueshme të ekonomisë;

Duke vlerësuar pavarësinë institucionale të Bankës së Shqipërisë në raport me ligjin, si dhe detyrimin për zbatimin dhe për raportimin e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë;

Duke vlerësuar angazhimin e Bankës së Shqipërisë për zbatimin e objektivave dhe detyrimeve të saj ligjore;

Vlerëson veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë për vitin 2019 dhe politikat e ndjekura prej saj në drejtim të:

- Përmbushjes me përkushtim dhe profesionalizëm të detyrave kushtetuese dhe ligjore gjatë vitit 2019, të pasqyruara edhe nga trendi pozitiv i zhvillimeve ekonomike e monetare të vendit;

- Rëndësisë që u është dhënë rekomandimeve të përcaktuara në rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2018, duke i përfshirë ato në strategjinë afatmesme 3-vjeçare të Bankës së Shqipërisë;

- Masave të marra sa u takon fenomeneve të mbiçmimit të kursit të këmbimit të monedhës vendase dhe efekteve të këtij mbiçmimi në secilën prej kategorive të risqeve, të cilat duket se po çojnë drejt normalizimit të tregut përkatës;

- Vijimit të procesit të përafrimit të rregulloreve dhe procedurave të brendshme institucionale me ato të sistemit evropian të bankave qendrore;

- Rritjes së bashkëpunimit ndër-institucional dhe, veçanërisht, të bashkëpunimit me autoritete të tjera mbikëqyrëse e rregullatore (si AMF, DPPP).

- Edukimit të publikut për përdorimin e parave virtuale dhe fushatave sensibilizuese për përdorimin e terminologjive “lek i vjetër”, “lek i ri”.

Kuvendi i Shqipërisë i paraqet Bankës së Shqipërisë, për vitin 2020, rekomandimet si më poshtë:

- Politika monetare duhet të vijojë të jetë stimuluese, me synim mbështetjen e kthimit të ekonomisë në ekuilibër dhe të inflacionit në objektiv brenda dy viteve të ardhshme;

- Instrumentet e përdorura gjatë vitit 2019 në drejtim të ruajtjes në nivele të ulëta të normës bazë të interesit, furnizimit me likuiditet të sektorit bankar dhe orientimit të tregut mbi kahun e prituri të politikës monetare duhet të vijojnë të përdoren edhe gjatë vitit 2020, për të siguruar mbështetjen e veprimtarisë së biznesit, ruajtjen e qëndrueshmërisë së tregut financiar dhe të kursit të këmbimit valutor;

- Kuadri rregullues, licencues dhe mbikëqyrës i sistemit bankar duhet të forcohet më tej, me qëllim që institucionet bankare të jenë të besueshme për ruajtjen e kursimeve të publikut, si dhe të afta për kreditimin e biznesit e të familjeve. Kuadri rregullues duhet të përafrohet më tej me standardet e Bazel III dhe të legjislacionit evropian. Monitorimi i konsolidimit të sektorit bankar duhet të jetë rigoroz, në funksion të forcimit të shëndetit dhe rritjes së konkurrencës së këtij sektori, si dhe përmirësimit të ofertës së kredisë;

- Mbikëqyrja e bazuar në rrezik, si një ndër elementet e rëndësishme të strategjisë së Bankës së Shqipërisë, duhet të vijojë e forcohet më tej. Duhet të përmirësohet më tej monitorimi për drejtimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve bankare bazuar në rrezik, duke rritur kërkesën për informacion dhe duke përmirësuar analizat përkatëse;

- Politikat e Bankës së Shqipërisë në drejtim të portofolit të kredisë duhet të përmirësohen më tej, për të ndikuar në reduktimin e kredive me probleme dhe për të mos lejuar krijimin e kredive të reja të kësaj natyre. Politika të tilla janë klasifikimi më konservator i një pjese të portofolit të kredisë, duke krijuar edhe fondet rezervë përkatëse, edhe sigurim të transparencës së plotë në marrëdhënie me klientët etj.;

- Banka e Shqipërisë duhet të vijojë e thellojë punën për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit MONEYVAL dhe të planit kombëtar të masave për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe forcimin e efektivitetit të procesit mbikëqyrës në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

- Kuadri për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në bankat me paaftësi paguese duhet të forcohet më tej, duke rritur aftësitë e bankave, plotësuar kuadrin rregullator dhe metodologjik, monitoruar Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe forcuar kapacitetet njerëzore e logjistike. Transparenca ndaj publikut, në rastet e mundshme të ndërhyrjeve të jashtëzakonshme në banka, duhet të rritet më tej, me qëllim që të minimizohen ndikimet në ekonominë reale, financat publike dhe stabilitetin financiar dhe veprimtaria e Bankës së Shqipërisë në këto raste të jetë e qartë;

- Banka e Shqipërisë duhet të vijojë punën për zbatimin e standardeve teknike, të krijuara nga Autoriteti Evropian për Bankat, si standarde të domosdoshme që nxisin ndërveprimin e institucioneve që ofrojnë shërbime pagesash në tregun evropian;

- Operacionet e Bankës së Shqipërisë duhet të synojnë miradministrimin e rezervës valutore, duke plotësuar nevojat për likuiditet në monedhë të huaj, të lidhura me: zbatimin dhe mbështetjen e politikës monetare dhe të kursit të këmbimit, ruajtjen e stabilitetit financiar, mbulimin e nevojave të vendit në periudha krize, ruajtjen e fondit të rezervës, si dhe përmirësimin e rezultatit financiar të investimit të rezervës valutore;

- Nxitja dhe funksionimi i mirë i sistemit të pagesave duhet të jetë në fokus të Bankës së Shqipërisë, duke u ofruar ekonomisë dhe publikut platforma dhe instrumente të besueshme e me kosto të ulët. Ruajtja e cilësisë së monedhave dhe kartëmonedhave është e rëndësishme për t'i ofruar ekonomisë dhe publikut një instrument pagese të sigurt;

- Forcimi i mirëqeverisjes së institucionit mbetet një drejtim tjetër i rëndësishëm i punës së Bankës së Shqipërisë. Harmonizimi i ligjit për Bankën e Shqipërisë me legjislacionin evropian të bankave qendrore është një hap pozitiv në këtë drejtim. Hartimi i ligjit të ri për Bankën e Shqipërisë ka qenë një ndër objektivat e përcaktuar në disa rezoluta të mëparshme për veprimtarinë e këtij institucioni, por ende nuk është realizuar. Banka e Shqipërisë duhet të përshpejtojë procedurat në këtë drejtim, për të krijuar një kuadër ligjor bashkëkohor.

Miratuar në datën 2.7.2020.

KRYETAR
Gramoz Ruçi